

VENDIM
Nr. 254, datë 3.9.2026

MBI PEZULLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE (SHA KESH)” SHA NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA TEC-et LUNDRUESE “TIGRI 1”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 50 mw, DHE “TIGRI 3”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 60 mw

Në mbështetje të nenit 16 dhe 136, pika 2, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 14, pika 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.9.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1950/29 prot., datë 2.9.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (sh.a. KESH)’ sh.a. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC-et lundruese “Tigri 1”, me kapacitet të instaluar 50 mw, dhe “Tigri 3”, me kapacitet të instaluar 60 mw”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH)” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1950 prot., datë 23.6.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC-et lundruese “Tigri 1”, me kapacitet të instaluar 50 mw dhe “Tigri 3”, me kapacitet të instaluar 60 mw, me vendndodhje në Portin e Triportit, në Gjirin e Vlorës.

- Me vendimin nr. 185, datë 6.7.2026, Bordi i ERE-s ka vendosur fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë.

- ERE botoi njoftimin për fillimin e kësaj procedure në median e shkruar në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s, në datat 7.7.2026 dhe 8.7.2026. Brenda afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data e fundit 5.8.2026) ka rezultuar se ka pasur të tilla, të cilat i janë dërguar KESH sh.a. dhe nga ana e shoqërisë janë depozituar parashtrime. Objeksionet e paraqitur dhe parashtrimet e shoqërisë mbi këto objeksionet janë në proces shqyrtimi.

- Në kuadër të shqyrtimit të aplikimit, ERE ka zhvilluar korrespondencën përkatëse me shoqërinë për plotësimin e informacionit/dokumentacionit të aplikimit, si dhe me institucionet kompetente, ndër të tjera me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) (shkresa nr. 1950/3 prot., datë 14.7.2026), Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) (shkresa nr. nr. 1950/7 prot., datë 14.7.2026), Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. (shkresa nr. 1950/5 prot. datë 14.7.2026) dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) (shkresa nr. 1950/6 prot. datë 14.7.2026), me qëllim verifikimin e përmbushjes së kërkesave ligjore dhe rregullatore për ushtrimin e veprimtarisë së kërkuar.

- MIE me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1950/16 prot., datë 5.8.2026, ka shprehur qëndrimin e saj, duke përcaktuar se “Referuar parashikimeve të kontratës së qirasë, operimit dhe mirëmbajtjes ‘Bareboat’” dhe Marrëveshje për Shërbimet O& me, me nr. 1660 prot., datë 4.4.2022, amenduar me kontratën nr. 1660/7 prot., datë 7.4.2022, me përfundimin e afatit të qirasë, asetet termike kalojnë në pronësi të KESH sh.a, në përputhje me nenet 15 dhe 16 të

kontratës. Në këto kushte, e ndryshimi i natyrës juridike të asetit është parashikuar shprehimisht në kontratë, në përputhje me kushtet e saj për kalimin e pronësisë dhe si i tillë nuk përbën dhënien e një të drejtë për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese dhe të depozitimit të energjisë, të cilat nuk janë objekt koncesioni sipas përcaktimeve të nenit 52, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

- OST sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1950/12 prot., datë 3.8.2026, ka bërë me dije se, për shkak të ndryshimit të statusit juridik të aseteve, KESH sh.a. duhet t’i drejtohet OST sh.a. për amendimin e Marrëveshjes së Lidhjes me Rrjetin e Transmetimit. Në vijim, KESH sh.a. ka depozituar kërkesën e drejtuar OST sh.a. për amendimin e Marrëveshjes së Lidhjes. Nuk rezulton të jetë depozituar pranë ERE-s dokumenti i amenduar/miratuar, por shoqëria ka bërë aplikimin e saj, e si e tillë ka detyrën për depozitimin e këtij dokumenti në ERE.

- Nga ana e AMBU-së nuk rezulton të jetë depozituar ndonjë qëndrim vijues, por rezulton se shoqëria ka një leje të vlefshme për përdorimin e burimit ujor deri në datën 15.3.2028.

- AKM me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1950/15 prot., datë 5.8.2026, ka informuar se KESH sh.a. disponon leje mjedisi me Kod III.1.C, me PN-1673-03-2023, duke referuar gjithashtu se shoqëria ka aplikuar për pajisjen me leje mjedisi me kod LC-8477-0102023 dhe duke depozituar dokumentacionin e aplikimit bashkëlidhur për vlerësimin e ERE-s.

- Duke qenë se informacioni i përcjellë me shkresën nr. 1950/15 prot., datë 5.8.2026, nuk adresonte në mënyrë të plotë çështjen e vlefshmërisë së lejes/lejeve mjedisore për operimin e TEC-eve dhe po ashtu, duke qenë se vlerësimi i dokumentacionit mjedisor, përcaktimi i lejeve mjedisore të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë, si dhe vlerësimi i vlefshmërisë dhe mjaftueshmërisë së tyre për operimin e instalimit përkatës nuk bëjnë pjesë në kompetencat ligjore të ERE-s, me shkresën nr. 1950/20 prot., datë 12.8.2026, ERE i ka kërkuar AKM-së të informojë nëse KESH sh.a. disponon të gjitha lejet e nevojshme mjedisore për operimin e TEC-eve lundruese “Tigri 1” dhe “Tigri 3”.

- Në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1950/26 prot., datë 27.8.2026, AKM ka informuar sërish se, nga verifikimi në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licencave, rezulton se KESH sh.a. disponon leje mjedisi me kod III.1.C, me PN-1673-03-2023, për të cilën ka depozituar pranë ERE-s edhe kopjen e lejes mjedisore, si dhe dokumentin me emërtimin “Leje”, me PN-1673-03-2023, ku pjesa takuese për afatin e vlefshmërisë nuk ka një përcaktim apo afat (është e paplotësuar).

- Për sa më lart, duke qenë se në pikën 1.5.2 përcaktohet se kjo leje është dhënë në bazë të kontratës së qirasë dhe në faqen 62 përcaktohet se: Kjo leje është e vlefshme vetëm për periudhën e vlefshmërisë së kontratës së qirasë për mjetet lundruese të prodhimit të energjisë elektrike dhe në kushtet kur, vetë KESH sh.a. ka njoftuar AKM-në, se pas përfundimit të afatit të qirasë, statusi juridik i asetit do të ndryshojë dhe ai do të vijojë të trajtohet dhe administrohet si aset i KESH sh.a., ERE i është drejtuar AKM-së me shkresën nr. 1950/28 prot., datë 1.9.2026, ku në referencë të gjithë sa më sipër, i është kërkuar qëndrim konkret nëse leja aktuale është e vlefshme apo shoqëria duhet të pajiset me leje apo akte të tjera mjedisore të nevojshme sipas legjislacionit në fuqi për operimin e TEC-eve lundruese “Tigri 1” dhe “Tigri 3”.

- Për gjithë sa më sipër parashtruar, referuar parashikimeve të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi, vlerësohet se marrja e qëndrimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM), lidhur me vlefshmërinë dhe efektet juridike të lejes/lejeve mjedisore të nevojshme për operimin e TEC-eve Lundruese “Tigri 1” dhe “Tigri 3”, është një çështje që lidhet drejtpërdrejt me verifikimin e mundësisë juridike dhe faktike të ushtrimit të veprimtarisë për të cilën kërkohet licencimi. Në këtë kuptim, vlerësohet se kjo përbën një çështje paraprake në kuptim të nenit 66 të Kodit të Procedurave Administrative, pasi zgjidhja e saj është parakusht për marrjen e

një vendimi përfundimtar mbi procedurën e licencimit, ndërkohë që ajo ka karakter të pavarur nga kjo procedurë dhe zgjidhja e saj i përket kompetencës së organeve/subjekteve përkatëse, dhe jo ERE-s.

Argumentimi ligjor

- Në nenin 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodit i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (çështja paraprake), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë.

- Po ashtu, në nenin 14, pika 10 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, parashikohet se Bordi i ERE-s, rast pas rasti, pas fillimit të procedurës, mund të vendosë të pezullojë vendimmarrjen e tij.

- Në këto kushte, vlerësohet e nevojshme pezullimi i afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë “KESH” sh.a për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC-et Lundruese “Tigri 1”, me kapacitet të instaluar 50 mw, dhe “Tigri 3”, me kapacitet të instaluar 60 mw, me vendndodhje në Portin e Triportit, në Gjirin e Vlorës, deri në depozitimin pranë ERE-s të qëndrimit përkatës të AKM-së mbi vlefshmërinë e lejes mjedisore të shoqërisë “KESH” sh.a. apo nëse shoqëria duhet të pajiset me leje apo akte të tjera mjedisore të nevojshme sipas legjislacionit në fuqi për operimin e TEC-eve lundruese.

- Me administrimin e këtij qëndrimi do të konsiderohet e ezauruar arsyeja që ka sjellë pezullimin e procedurës dhe për rrjedhojë, procedura administrative rifillon dhe vijon shqyrtimi i kërkesës së shoqërisë “KESH” sh.a., në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pezullojë procedurën administrative të licencimit të shoqërisë “Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (sh.a KESH)” sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga TEC-et Lundruese “Tigri 1”, me kapacitet të instaluar 50 mw, dhe “Tigri 3”, me kapacitet të instaluar 60 mw, me vendndodhje në Portin e Triportit, në Gjirin e Vlorës.

2. Pezullimi do të zgjasë deri në administrimin nga ERE të qëndrimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për vlefshmërinë e lejes/lejeve mjedisore të shoqërisë “KESH” sh.a për operimin e TEC-eve lundruese “Tigri 1” dhe “Tigri 3”.

3. Me administrimin nga ERE të qëndrimit të AKM-së që adreson çështjet e përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, konsiderohet e ezauruar arsyeja e pezullimit dhe procedura administrative rifillon, duke vijuar shqyrtimi i kërkesës së shoqërisë “KESH” sh.a. për licencim.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (sh.a. KESH)” sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), shoqërinë “Operatori Sistemit Transmetimit” (OST) sh.a. dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM), si dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

